

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PDK konteston në Kushtetuese formimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e kryesisë
ADRESA	https://albeu.com/kosove/pdk-konteston-ne-kushtetuese-formimin-e-kuvendit-dhe-zgjedhjen-e-kryesise/1010478/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 08:28:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:21:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	275a27dd9816a43e3c94c4c2e1b8c7596c747a42ceec4008428fbcabdeddbbac
TEKSTI	9669c8fa3b28b9ba096c924dbb0a2b747893594e230055509a1709a3d47305da
PAMJA	08385efc953acba261bd85294bc350b5cd4287cf83489f97fbff08c43a3aa003

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	193a62cad64d1669e9330254a9c4eae7ae32363f36cf90ece25cacb3b118b0c2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9dba7e1cf5e08da052e8f7bcad4dfd2bc0436d1ed5e23cf11abc817a3e1dcfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/193a62cad64d1669e9330254a9c4eae7ae32363f36cf90ece25cacb3b118b0c2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

PDK konteston në Kushtetuese formimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e kryesisë



Partia Demokratike e Kosovës ka depozituar pranë Gjykatës Kushtetuese një ankesë ku kërkon të vlerësohet nëse procesi i konstituimit të Kuvendit, përfshirë edhe përzgjedhjen e kryetares dhe nënkryetarëve, ka qenë në pajtim me ligjin themelor të vendit.

Pas paraqitjes së kërkesës, përfaqësuesit e kësaj partie, Arian Tahiri, Përparim Gruda dhe avokati Faton Fetahu, theksuan urgjencën e një vendimi nga kjo gjykatë. Sipas tyre, veprimet e institucioneve që burojnë nga një legjislativ, i cili pretendon se është ngritur në shkelje të Kushtetutës, rrezikojnë të sjellin pasoja të rënda ligjore dhe institucionale.

Kreu i grupit parlamentar të PDK-së, Arian Tahiri, sqaroi se objekti i ankesës përfshin vlerësimin e vendimit për shpalljen e Kuvendit të konstituuar, zgjedhjen e kryetares, si dhe procedurën dhe votimin për nënkryetarët.


"Ne kemi shprehur vazhdimisht besimin tonë në punën dhe integritetin profesional të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, konsiderojmë se është e domosdoshme dhe imediate të merret një vendim sa më i shpejtë, me qëllim që të parandalohen dëme dhe situata më të komplikuar në sferën juridike dhe institucionale," u shpreh Tahiri.

Ai paralajmëroi se edhe qeveria e dalë nga një Kuvend i tillë mund të miratojë akte të paligjshme, nëse vërtetohet se themeli i saj, pra konstituimi i Kuvendit, është antikushtetues. "Për çdo vendim të jashtëligjshëm, ne do t'i drejtohem Gjykatës për ta rikthyer vendin në shinat kushtetuese dhe për të siguruar respektimin e institucioneve dhe aktit më suprem juridik, Kushtetutës së Kosovës," shtoi ai.

Deputeti Përparim Gruda argumentoi se, bazuar në Kushtetutë dhe një vendim paraprak të Gjykatës Kushtetuese, afati për formimin e Kuvendit ishte 8 gushti. Ai pohoi se më vonë Lëvizja Vetëvendosje kishte vendosur si datë kufi politike 6 shtatorin, por që as ky afat nuk u mbajt.

"Pasi u teikalua një afat kushtetues dhe një afat i vetë-imponuar politikisht, ne u qindëm përpara një situatë të

të fundit /



T'i bjerë kokës", plas kritikë ndaj Florin Bratut te Partizani:...



Një grup qytetarësh zgjedhin të protestojnë te Zogu i Zi, ndërhyjnë...



Mourinho e ka vendosur, kjo pritë të jetë mbrojtja ndaj...



Ishte me leje, Alket Rizai nuk u kthye në burg pas sherrit për...



Berisha për nisjen e vitit shkollor: Shqipëria humbi rreth 5,900...



Nisja e vitit të ri shkollor shkakton kaos në qarkullin rrugor, radh...



11 zjarre të regjistruara në Maqedoni gjatë 24 orëve, një prej tyre...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

vështirë. Megjithatë, vendosëm të merrnim pjesë në seancat e 9 dhe 11 shtatorit, por as ato nuk sollën zgjidhje. Kur kuptuam se përveç shkeljeve të afateve, po bëhej tallje me institucionet dhe qytetarët përmes seancash absurde dhe justifikimesh boshe, vendosëm t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese. Ndonëse ajo ka një aktgjykim për këtë çështje dhe kishim hezituar, tani që pushteti ka dalë tërësisht jashtë kontrollit kushtetues, nuk na mbeti rrugë tjetër," deklaroi Gruda.

Ai iu referua një parimi juridik sipas të cilit askush nuk mund të nxjerrë përfitime nga shkeljet e veta. "Lëvizja Vetëvendosje nuk mund t'i shkelë të gjitha afatet dhe në fund të përfitojë prej këtyre veprimeve. Nuk mund të vendoset një precedent ku një subjekt politik zëvendëson afatet kushtetuese me të vetat. Asnjë shumicë, sado e madhe, nuk është mbi Kushtetutën," theksoi ai.

Gruda nënvizoi se roli i Kushtetutës është të kufizojë pushtetin dhe paralajmëroi se të nesërmen do të depozitohet një kërkesë tjetër, këtë herë për zgjedhjen e qeverisë së re. Ai argumentoi se nëse Kuvendi është formuar në kundërshtim me ligjin themelor, atëherë të gjitha vendimet që dalin prej tij janë të cenueshme kushtetuese. "Nesër do të kontestojmë edhe formimin e Qeverisë. Nuk mund të vazhdojmë të lejojmë që Kuvendi të zgjedhë organet kryesore të shtetit duke krijuar dilema të thella kushtetuese dhe duke minuar legjitimitetin," shtoi ai, duke përmbyllur se në një demokraci kushtetuese, legjitimiteti nuk buron thjesht nga numri i votave, por nga respektimi rigoroz i Kushtetutës.

Avokati Faton Fetahu detajoi tri pikat kryesore të kërkesës së dorëzuar në Kushtetuese. Sipas tij, ato kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjes së kryetares së Kuvendit, me ndryshimin e procedurës së votimit për nënkryetarët, dhe me faktin se Kuvendi u shpall i konstituuar pa pasur një anëtar të Kryesisë nga grupi i dytë më i madh parlamentar.

Fetahu theksoi qëndrimin e PDK-së se Kuvendi nuk është konstituuar në pajtim me Kushtetutën, Rregulloren e tij dhe praktikën gjyqësore të Kushtetueses. Ai argumentoi se mungesa fizike e deputetëve të PDK-së në sallë gjatë votimit për anëtarët e Kryesisë nuk përbën heqje dorë nga e drejta e tyre për të propozuar kandidatë. Ai shtoi se grupi parlamentar i PDK-së ka kërkuar në mënyrë të vijueshme mbajtjen e seancës gjatë gjithë periudhës kur nuk kishte tentativa për ta bërë këtë, dhe se rasti duhet parë në tërësinë e tij, jo vetëm përmes prizmit të pjesëmarrjes në një seancë të vetme.

Në fund, Fetahu shprehu bindjen se gjykata do ta pranojë kërkesën dhe do të vendosë me shpejtësi një masë të përkohshme, me synimin për të shmangur atë që ai i cilësoi si dëme të pariparueshme për interesin publik. "Ne presim që ky rast të konfirmohet nga Gjykata Kushtetuese si shkelje kushtetuese dhe që kërkesa të shpallet e pranueshme. Mbi të gjitha, është e domosdoshme të vendoset sa më parë masa e përkohshme," përfundoi ai.

Shtuar më 14.09.2026 10:21

Tags: [konstituimi](#), [kuvendi](#), [pdk](#), [Përparim](#)
[Gruda](#)



Kabineti i ri qeveritar Kurti 4 zhvillon sot takimin inaugurues



Në Hagë vijon seanca ndaj Thaçit dhe të bashkakuzuarve, sot...



Kurti paralajmëron para vendimit për ish-udhëheqësit e UÇK-së:...



Nisin aplikimet për konvikte dhe mensën e studentëve në Prishtinë për vitin...



PDK-ja paralajmëron dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese



Policia e Kosovës sqaron masat e planifikuara për 16 shtatorin



Qeveria Kurti 4 votohet me 62 vota, ndërsa përplasja politike kalon te Presiden...



A rrezikohen shqiptarët nga politikat e AfD-së në Gjermani? Deputeti Tobia...



Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.